



REPUBLIKA E SHQIPERISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

NR.REGJ.THEMELTAR (SP) 1359
1882

NR.VENDIMI

DATË REGJISTRIMI (SP) 10.03.2022

DATË 26.07.2022

NR.REGJ THEMELTAR 1832

DATË REGJ.THEMEL 11.05.2022

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga :

GJYQTAR – KUJTIM VRANIÇI

Asistuar nga sekretari gjyqësor Romeo Shehu, në Tiranë, më datë 26.07.2022, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike çështjen penale, që i përket :

KËRKUES:Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori i çështjes, **z. Julian Xhengo.**

ME OBJEKT:Dërgimin në gjyq të çështjes penale Nr.4810 të vitit 2021,

KUNDËR:

TË PANDEHURVE:1- **Altin Plaku**, i biri i Ibrahim dhe i Xhevrie, i datëlindjes 22.04.1986, lindur ne Shijak dhe banues në Maninas të Vogël, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim 8-vjeçar, me gjëndje familjare i martuar me dy fëmijë, me gjëndje gjyqësore i padënuar me parë, hetuar dhe gjykuar nën masën e sigurimit personal "Arrest në burg", mbrojtur me deklaram në seancë gjyqësore nga avokati **Ferdinand Doja**, Anëtar i Dhomës se Avokatise Tiranë, me Nr. 1345 Liçense dhe NIPT K 61510040 T.

2-**Mondi Vervalj**, i biri i Ramazan dhe i Dhurata, i datëlindjes 06.09.1963, lindur ne Shijak dhe banues në Maminas të Vogël, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, i pa arsimuar, me gjëndje familjare i martuar, me gjëndje gjyqësore i padënuar, hetuar dhe gjykuar nën masën e sigurimit personal "Arrest në burg", mbrojtur me deklaram në seancë gjyqësore nga avokati **Ferdinand Doja**, Anëtar i Dhomës se Avokatise Tiranë, me Nr.1345 Liçense dhe NIPT K 61510040 T.

3- **Zyber Tusha**, i biri i Alush dhe i Nafije, i datelindjes 31.03.1979, lindur në Durrës dhe banues në fshatin Maskuri, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim 8-vjeçar, me

gjëndje familjare i divorcuar me një femije, me gjëndje gjyqësore i padënuar, hetuar dhe gjykuar nën masën e sigurimit personal "Arrest në burg", mbrojtur me deklaram në seancë gjyqësore nga avokati **Ferdinand Doja**, Anëtar i Dhomës së Avokatise Tiranë, me Nr.1345 Liçense dhe NIPT K 61510040 T.

AKUZUAR:Për kryerjen e veprës penale "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal.

4- **Qerim Tresa**, i biri i Hamid dhe i Ike, i datelindjes 20.03.1963, lindur dhe banues në fshatin Pezë të Rrethit Tiranë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, hetuar fillimisht me masë sigurimi "arrest në burg" dhe gjykuar nën masën e sigurimit personal "arrest në shtëpi", **në mungesë të vullnetshme**, përfaqësuar me Prokuror të Posaçme nga avokati **Arbër Hoxha**, Anëtar i Dhomës së Avokatise Tiranë, me Nr.4252 Liçense, (**në mungesë**), si dhe avokati i caktuar kryesisht nga gjykata në seancën e fundit **Edvis Gorishti**, Anëtar i Dhomës së Avokatise Tiranë, me Nr.9537 Liçense dhe NIPT L 81309066 E.

AKUZUAR:Për kryerjen e veprës penale "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal dhe "Mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë", të parashikuar nga Neni 280 i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 331 të K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi administroi provat në seance gjyqësore, shqyrtoi çështjen në tërësi, dëgjoi konkluzionet përfundimtare të palëve, të cilat kërkuan:

-Përfaqësuesja e Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Tiranë:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Altin Plaku**, për kryerjen e veprës penale "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal, dënimin e tij me **pesë vjet burgim**.

Në aplikim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit **Altin Plaku**, i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet **tre vjet e katër muaj burgim**.

Në zbatim të Nenit 59 të K.Penal, pezullimin i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë në provë për një periudhë prej **tre vjetësh** me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mos kryejë vepra tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Mondi Vervali**, për kryerjen e veprës penale "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal, dënimin e tij me **pesë vjet burgim**.

Në aplikim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit **Mondi Vervali**, i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet **tre vjet e katër muaj burgim**.

Në zbatim të Nenit 59 të K.Penal, pezullimin i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë në provë për një periudhë prej **tre vjetësh** me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mos

kryeje veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Zyren Vendore të Shërbimit të Provës dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Zyber Tusha**, për kryerjen e veprës penale "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal, dënimin e tij me **pesë vjet burgim**.

Në aplikim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit **Zyber Tusha**, i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet **tre vjet e katër muaj burgim**.

Në zbatim të Nenit 59 të K.Penal, pezullimin i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë në provë për një periudhë prej **tre vjetësh** me kusht që gjatë kohës së provës i pandehuri të mos kryeje veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Zyren Vendore të Shërbimit të Provës dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar.

4. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Qerim Tresa**, për kryerjen e veprës penale "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal, dënimin e tij me **pesë vjet burgim**.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Qerim Tresa**, për kryerjen e veprës penale "Mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë" të parashikuar nga Neni 280 i Kodit Penal, dënimin e tij me **një vit burgim**.
- Në zbatim të Nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve të pandehurit **Qerim Tresa**, i caktohen një dënim i vetëm me **gjashtë vjet burgim**.
- Në aplikim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit **Qerim Tresa**, i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet me **katër vjet burgim**.
- Vujatja e dënimit për të pandehurin **Qerim Tresa**, të fillojë nga dita e arrestimit të tij dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
- Asgjësimin lëndës narkotike
- Shpenzimet procedurale në shumën 3000 Lek tju ngarkohen solidarisht të pandehurve.

-Mbrojtja e të pandehurit Altin Plaku, Mond Vervali dhe Zyber Tusha, Av. Ferdinand Doja: Dënimin e secilit prej të pandehurve me kohën e paraburgimit.

-I pandehuri Altin Plaku u shpreh: Dakort me avokatin, tregoi pendesë të thellë për veprimet e kryera dhe kërkoi mëshirë nga gjykata.

-I pandehuri Mond Vervali u shpreh: Dakort me avokatin, tregoi pendesë të thellë për veprimet e kryera dhe kërkoi mëshirë nga gjykata.

-I pandehuri Zyber Tusha u shpreh: Dakort me avokatin, tregoi pendesë të thellë për veprimet e kryera dhe kërkoi mëshirë nga gjykata.

-Mbrojtja e të pandehurit Qerim Tresa, Av. Edvis Gorishti: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Qerim Tresa, për veprat penale që ai akuzohet "Kultivimi i bimëve narkotike" në bashkëpunim parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal, por nëqoftë se gjykata çmon se ka elemente të veprës penale dhe e gjen atë fajtor kërkoi uljen e dënimit dhe dënimin alternativ, duke aplikuar kërkesat e Nenit 59 të Kodit Penal.

-I pandehuri Qerim Tresa: Në mungesë.

V Ë R E N

Se, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në respektim të parashikimeve të Nenit 331 të K.Pr.Penale, është paraqitur kërkesa me objekt: Dërgimin në gjyq të çështjes penale Nr.4810 të vitit 2021, në ngarkim të të pandehurëve:

1. **Altin Plaku**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal.
2. **Klajdi Tresa**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i K.Penal.
3. **Mondi Vervali**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i K.Penal.
4. **Qerim Tresa**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal dhe “Mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë”, të parashikuar nga Neni 280 i Kodit Penal.
5. **Zyber Tusha**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i K.Penal, duke i bashkëlidhur kërkesës edhe aktet dhe provat që përmban fashikulli përkatës.

Përpara shqyrtimit të kërkesës, Gjykata mori kryesisht në shqyrtim çështjen e juridiksionit gjyqësor penal dhe të kompetencës lëndore dhe tokësore në shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi. Në bazë të Nenit 69, 74, 76 dhe 13/2 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata konstatoi se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata në çështjen objekt gjykimi vendosi të njoftojë palët për datën dhe orën e seancës paraprake të paktën 10 ditë përpara zhvillimit të saj, në mënyrë që t’u japë mundësinë të njihen me të gjitha aktet e hetimit paraprak dhe të përgatisin pretendimet e tyre. Në çështjen objekt gjykimi rezultoi të mos ketë viktimë.

Nga aktet e ndodhura ne dosje rezulton se seicilit prej të pandehurve i janë komunikuar të gjitha aktet proceduriale hetimore të kryer nga organi procedues.

Nga aktet e ndodhura në fashikullin e gjykimit rezultoi e provuar se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane me vendimin Nr. 2171 Akti, datë 03.12.2021 ka caktuar masen e sigurimit “arrest në burg”, në mungesë për të pandehurin Klajdi Qazim Tresa. Në vijim Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka urdhëruar kërkimin dhe njoftimin e këtij shtetasi, por nuk është bërë të mundur gjetja dhe njoftimi i tij dhe është deklaruar ikja e tij me vendimin Nr. 258 Akti datë 04.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane. Kurse njoftimi për përfundimin e hetimeve, është nënshkruar nga mbrojtësja e caktuar kryesisht në hetimet paraprake, avokate Nevila Pushi, Anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë.

Në seancë paraprake, gjykata pasi konstatoi se për të pandehurin Klajdi Tresa hetimet kanë përfunduar në mungesë të tij, urdhëroi njoftimin e tij nëpërmjet oficerëve të policisë gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe sipas përgjigjeve të kthyerë për gjykatën nga të gjitha komisariatet që ka në juridiksion kjo drejtori, nuk u bë e mundur gjetja dhe njoftimi i tij, pasi është person i shpallur në kërkim, (shih në dosje). Gjithashtu gjykata urdhëroi njoftimin e të pandehurit Klajdi Tresa edhe sipas dispozitave ligjore të parashikuar në Nenin 140 e vijues të Kodit të Procedurës Penale dhe sipas përgjigjes të vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë, me shkresën Nr.15776/1 Prot. datë 28.04.2022, rezultoi se kjo bashki ka kryer brenda datës afishimin e shpalljes publike. Ndodhur në këto kushte, Gjykata në zbatim të Nenit 332/b prg.4 të K.Pr.Penale, e shqyrtoi kërkesën e organit të akuzës në mungesë të të pandehurit Klajdi Tresa, duke i garantuar mbrojtës kryesisht avokaten **Vjollca Pustina**, Anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë.

Kurse të pandehurit Altin Plaku, Mondi Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa gjatë hetimeve paraprake nuk kanë paraqitur kontestime, ndërsa në seancën paraprake, asistuar edhe nga mbrojtësit ligjor respektive të tyre, paraqitën kërkesë për gjykim të shkurtuar, konform Nenit 332/c pika 3 dhe 403 e vijues të K.Pr.Penale, duke e pranuar plotësisht akuzën në ngarkim të tyre.

Kurse për të pandehurin Klajdi Tresa, pasi degjoi mbrojtësen ligjore të tij, avokate Vjollca Pustina, e cila nuk pati kërkitime të parashikuara nga Neni 332/c i K.Pr.Penale, për pavlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake, papërdorshmërinë të provave, nevojën për marrje të provave të tjera, **por ishte dakort për dërgimin e çështjes në gjyq, duke mos i paraqitur dhe kërkuar gjykates kërkesë për gjykim të posaçëm,kjo për shkak se nuk kishte targer ligjor të lëshuar nga vete i pandehuri Klajdi Tresa.**

Nisur nga sa më sipër, gjykata pasi u njoh me kërkesat e palëve në proces bazuar në Nenin 93 germa "ç" të K.Pr.Penale, procedoi me veçimin e çështjes për të pandehurin Klajdi Tresa, i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284/2 i K.Penal dhe dërgimin për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, Seksioni i Themelit, duke iu nënshtruar shortit elektronik.

Gjykata pasi dëgjoi parashtrimin e përfaqësuesit të prokurorisë pasi u njoh me kërkesat e palëve në proces bazuar në Nenin 93 germa "ç" të K.Pr.Penale, procedoi me veçimin e çështjes për të pandehurin Klajdi Tresa, i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284/2 i K.Penal dhe dërgimin për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, Seksioni i Themelit, duke iu nënshtruar shortit elektronik dhe pranoi kërkesën e të pandehurve Altin Plaku, Mondi Vervali, Qerim Tresa dhe Zyber Tusha, të parashtruar nëpërmjet mbrojtësve ligjor të tyre, në bazë të Nenit 332/dh germa "c", ndryshuar me Ligjin Nr. 41 të vitit 2021 si dhe Nenin 405/6 të K.Pr.Penale, pasi çmon se çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet, e zhvilloi gjykimin sipas kërkesave të këtij neni, pra duke u bazuar në gjendjen që janë aktet e procedimit penal Nr. 4810 të vitit 2021, të cilat i bashkangjiten fashikullit të gjykimin.

Nga diskutimi gjyqësor i fakteve dhe rrethanave të çështjes, rezultoi e provuar se:Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 02.07.2021 ka regjistruar procedimin penal Nr.4810, për veprën penale të "Kultivimit të bimëve narkotike", të parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal.

Ky procedim është regjistruar mbi bazën e informacionit për referimin e veprës penale dhe materialeve shoqëruese të dërguara nga Komisarjati i Policisë Nr.6 Tiranë me shkresën Nr.2913/k, datë 02.07.2021.

Më konkretisht nga përmbajtja e materialit hetimor rezulton se:

Më datën 28.06.2021 dhe 29.06.2021 nga punonjësit e policies se Komisarjatis Nr.6 është marre informacion nga burimet konfidenciale se ne fshatin Dorz, jane pare persona duke levizuar ne oret e para te mengjesit dhe dyshohet se keta persona merren me kultivimin e lendeve narkotike te llojit canabis sativa ku shtetasi Klajdi Tresa është nje nga te dyshuarit. Po keshtu ne te dy informacionet e tjera sqarohet se duke qene se burimi ishte teper i sigurt per ate cfare na informonte është kordinuar puna me eproret me qellim kontrollin e vendit ku ishte informacioni.

Per kete fakt me date 30.06.2021 ne zbatim te planit te masave kunder kultivimit te lendeve narkotike grupi kontrollit ne perberje, pergjegjes grupi oficeri krimeve, ndihmes specialist I policimit ne komunitet, agjenti I policise kriminale kane shkuar ne fshatin Dorz me qellim verifikimin e informacioneve te mara ne rruges operative. Se bashku me grupin e punes kemi kaluar ne adresen e dhene nga burimi ku është konstatuar se ne ane te rruges lidhese te fshatit ne mes te pyllit siperfaqe e shpyllezuar nga ana e majte ne drejtim me fshatin Dorz është gjetur nje Parcele me bime e dyshuar si ajo e lendes narkotike e llojt canabis sativa.

Nga ana e grupit hetimor, ne menyre sekrete, është fotografuar parcela me bime te dyshuar si cannabis sativa dhe është lokalizuar edhe me GPS. Me pas është fiksuar vendi i ngjarjes me procesverbal konform procedures standarte. Bima mendohet se ka rreth nje jave qe mund te jete hedhur per shkak se niveli i saj nga bazamenti i tokes është vetem disa centimetra. Prane parceles ndodhet dhe nje depozite metalike uji te cilen nuk patem mundesi ta verifikojme nese është e mbushur me uje apo jo per shkak se nuk donim te linim gjurme apo te dukeshim nga personat qe mund te naurvejonin. Sic është theksuar dhe me siper pasi është fotografuar dhe lokalizuar parcela e dyshuar me bime narkotike grupi është terhequr dhe është larguar per ne komisarariat.

Me qëllim thellimin e dyshimit nga ana e organit të prokurorisë jane bërë vzhgime nga distanca dhe me date 30.06.2021 është parë shtetasi Klajdi Tresa duke dale nga ajo zone e pyllzuar me rroba me balte gie e cila përforcon dyshimin se ky shtetas është pjesmarres ne këtë aktivitet kriminal. Me qëllim dokumentimin ligjore te kësaj ngjarjen nga ana jone c'mohet e arsyeshme mbajtja në interceptim e ketyre shtetasve pasi ne rruga operative janë saktësuar numrat e telefonit që përdoren nga ata e konkretish shtetasi Klajdi Tresa i biri i Qazim dhe i Hamide i datelindjes 23.01.1997 , identifikuar me numër ID-J70123035 Lika në përdorim numerat 0693651586, dhe 0693796484. Nedrsa i ati shtetasi Qazim Tresa i biri i Hamdi dhe i Ike, i datelindjes 20.03.1963 identifikuar me numer ID- G30320126C, ka në përdorim numrin telefonik 0682369330 që të dy banore të fshatit Dorz, Njesia Administrative Peze Tirane."

Përsa më sipër Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 03.07.2021, ka vendosur miratimin e vendimit të prokurorit të cështjes për lejimin e përgjimit të numrave të telefonave celularë 0693651586, 0693796484 dhe 0682369330 për të gjitha thirrjet hyrëse dhe dalëse në këta numra telefoni, sipas kërkesave të nenit 222/3 të Kodit të Procedures Penale për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) ditore.

Nga informacioni i përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore në datën 26.07.2021 ka rezultuar se: Nga interceptimi i numrave te mesiperm aktiv ka qene numeri i shtetasit, Klajdi Tresa 0693796484, i cili gjate kohes qe është interceptuar ka patur kontakte te vazhdueshme dhe me interes per hetimin me dy numera tjere 0695310980 dhe 0676694609. Pas verifikimit te kryer ne kompanite telefonike me shkresat perkatese ne pergjigje te shkresave kemi mesuar se numeri 0695310980 është prone e shtetasit Altin Ibrahim Plaku dhe numeri 0676694609, prone e shtetasit Emiljan Bujar Vervali, qe te dy lidhje e ngushte shoqerore dhe miqesore te shtetasit Klajdi Tresa, dhe implikojne veten ne komunikimet telefonike. Me date 17.07.2021 është nderprere interceptimi per shkak te permbushjes se afatit kohore, dhe duke marre faktin se kemi te dhena nga vzhgimi se parcela me bime narkotike është ne fundet e saj qe nga momenti ne moment mund te korret nga autoret është e domosdoshme venjas ne interceptim e numerave te ketyre shtetasve vetem me qellim kapjen e autoreve ne flagrante dhe goditjen e ketij fenomeni kriminal...."

Në datën 29.07.2021, rreth orës 0310, janë kapur në flagrancë në mes të arës ku janë kultivuar bimë [et] narkotike shtetasit Mond Vervali dhe Zyber Tusha të cilët ishin duke vaditur bimët. Po kështu, është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit Qerim Tresa për shkak se në telefonin e tij janë gjetur komunikime të vazhdueshme nga të cilet rezulton se ai ka qenë i përfshirë në kultivimin e bimëve narkotike në bashkpunim me shtetasit e mësipërm.

Nga procesverbalet e transkriptimeve të bisedave telefonike të përgjuara rezulton se bashkëpunëtorë në kultivimin e bimëve narkotike janë edhe shtetasit Klajdi Tresa dhe Altin Plaku. Rezulton se këta shtetas kanë komunikime relativisht të konsiderueshme për sigurimin e paisjeve të nevojshme për procesin e kultivimit të bimëve narkotike (automjete, zorrë uji, etj).

Nga hetimet paraprake, ka rezultuar gjithashtu se, në telefonin e shtetasit Mond Vervali janë gjetur pamje filmike të tokës ku kultivoheshin bimët narkotike (1.114 bime) dhe të shtetasve Zyber Tusha, Altin Plaku dhe Klajdi Tresa.

Po kështu, ka rezultuar se në banesën e shtetasit Qerim Tresa është gjetur edhe një arme gjahu tip "Cifte" me numer K06757.

Nga verifikimi i kryer në sistem rezulton se ky shtetas është i pajisur me leje për armë gjahu me numër AA170001.

Mbi bazën e këtyre fakteve të parashtruara sa më sipër, nga përfaqësuesi i organit të prokurorisë u kërkuar deklarimi fajtor i secilit prej të pandehurve Altin Plaku, Mondi Vervali, Zyber Tusha, për kryerje të veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal dhe Qerim Tresa, për kryerje të veprave penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal dhe “Mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë”, të parashikuar nga Neni 280 i Kodit Penal, **dhe dënimin e secilit prej tyre si në pjesën hyrëse të këtij vendimi.**

Kurse të pandehurit Altin Plaku, Mondi Vervali dhe Zyber Tusha nëpërmjet mbrojtësit ligjorë të tyre, u shpreh se duke pasur parasysh se vepra penale e kryer prej tyre konsiderohet me një rezikshmeri të zakonshme, pra jo të lartë, duke patur parasysh se vetë të pandehurit nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, duke patur parasysh edhe kriteret e Nenit 48 të Kodit Penal të cilat lidhen me rrethanat lehtësuese, jemi të mendimit se koha e paraburgimit ju ka shërbyer atyre mjaftueshem për të ri integruar në jetë, duke i kërkuar gjykatës që masa e dënimit të jetë ajo e kohës së paraburgimit si më e përshtatshme për këta të pandehur.

Ndërsa i pandehuri Qerim Tresa, nuk u paraqit në asnjë seancë gjyqësore, madje as mbrojtësi i zgjedhur prej tij avokat Arbër Hoxha, duke u bërë disa here pengesë për ecurinë e gjykimit, dhe në seance e fundit nëpërmjet mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata, avokatit Edvis Gorishti, i cili kërkoi pafajësi për këtë të pandehur, për veprat penale që ai akuzohet “Kultivimi i bimëve narkotike” në bashkëpunim parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", parashikuar nga Neni 280 i Kodit Penal, por nëqoftë se gjykata çmon se ka elementë të veprave penale dhe e gjen atë fajtor kërkoi uljen e dënimit dhe dënimin alternativ, duke aplikuar kërkesat e Nenit 59 të Kodit Penal.

Vlerësimi i Gjykatës.

Gjykata, paraprakisht evidenton faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: **a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive.** Proveshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston.

Prandaj, në çështjen konkrete, Gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të dënohet.

Atëherë fillimisht në lidhje me akuzën ndaj të pandehurve të pandehurve Altin Plaku, Mondi Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa, për veprën penale që ata akuzohen “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal, Gjykata konstaton se të katërt të pandehurit i kanë konsumuar elementët e figurës së kësaj vepre penale.

Gjithashtu edhe në lidhje me akuzën ndaj të pandehurit Qerim Tresa, për veprën tjetër penale që ai akuzohet “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, parashikuar nga Neni 280 i Kodit Penal, Gjykata konstaton se ky i pandehur i ka konsumuar të gjithë elementët e figurës së kësaj vepre penale.

Në këto rrethana, të ndodhur përpara faktit të parashtruar më sipër, pretendimeve dhe provave të administruara në gjykim, Gjykata konkludon se në veprimet e të pandehurve Altin Plaku, Mondit Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa, janë të pranishëm të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t'i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale "Kultivimi i bimëve narkotike", të parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal. **Po ashtu të pranishëm janë edhe** elementë të figurës së veprës penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të gjuetisë dhe sportive", parashikuar nga Neni 280 i Kodit Penal, veprë e cila rëndon vetëm mbi të pandehurin Qerim Tresa.

Këto fakte të paligjshme për të cilat akuzohen të pandehurit Altin Plaku, Mondit Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa, u provuan plotësisht me një sërë provash shkresore, të cilat u çmuan nga ana e gjykatës në harmoni me njëra tjetrën, pra në tërësi aktet e procedimit penal Nr.4810 të vitit 2021 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Përsa i përket cilësimit juridik të veprës penale.

1-Neni 284 i Kodit Penal, nën titull "Kultivimi i bimëve narkotike", në tërësi të tij parashikon se:

- *Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, pa leje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.*
- **Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.**
- *Organizmi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.*

Objekti i veprës penale: Janë veprimet e të pandehurve Altin Plaku, Mondit Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa, që kanë cënuar marrëdhëniet juridike që rregullojnë rregullojnë kultivimin e bimëve narkotike, të cilat shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike e psikotrope.

Nga ana objektive: Kjo veprë penale, është konsumuar nga të pandehurit Altin Plaku, Mondit Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa me veprime aktive, në bashkëpunim me njëri tjetrin nepermjet kultivimit të bimëve narkotike, në mënyrë të kundraligjshme e shoqërisht të rrezikshme.

Në rastin konkret ata kanë shpyllezuar një sipërfaqe të konsiderueshme toke nga ana e majte në drejtim me fshatin Dorz, duke krijuar një parcele të posaçme, me qëllim kultivimin e një sasi të konsiderueshme bimësh narkotike, të cilat sipas edhe Aktit Nr.8428 datë 27.08.2021 (Per bimët sekuestruar në vendin e quajtur "Shpati i Maknorit", fshati Pezë, datë 29.07.2021, Tiranë), në përfundim të tij është arritur në konkluzionin se:

1. *"Bimët objekt ekspertimi janë bime Cannabis Sativa L.*
2. *Analiza me GC-MS për bimët, objekt ekspertimi tregoi për praninë e THC-së në përqëndrim më të madh se 0.1%".*

Po ashtu edhe sipas Aktit të Ekspertimit vlerësues i provave materiale, për ngjarjen e datës 29.07.2021, në përfundim të tij është arritur në konkluzionin se: "Ne objektet e ekspertimit të fiksuara në cilësinë e provës materiale në vendin e ngjarjes "kultivim bime si ajo narkotike", ndodhur në datën 29.07.2021, në vendin e quajtur Shpati Maknorit, Peze e Madhe Tirane, u përftua 1(nje) gjurmë

papilare e emertuar "TR/1895/21/A" e vlefshme per identifikim. Gjurma ka vlere per krahasim vizual vetem me persona konkrete.

Subjekti i veprës penale: Të katërt të pandehurit Altin Plaku, Mondi Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa janë subjekt i përgjithshëm i kësaj vepre penale, pasi sipas të dhenave në dosje rezulton se ata janë mbi 14 vjeç, të përgjegjshëm para ligjit penal, pasi nuk u konstatua asnjë shkak të parashikuar nga Nenet 12/2 dhe 17 të Kodit Penal që i përjashton ata nga përgjegjësia penale. Gjithashtu gjatë gjykimit nuk u ngrit dhe nuk u provua ndonjë pretendim për papërgjegjshmëri mendore të secilit prej tyre, në kryerjen e veprës penale për të cilën ata akuzohen.

Ana subjektive: Veprimet e të pandehurve Altin Plaku, Mondi Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa, janë kryer në bashkëpunim me njeri-tjetrin dhe me dashje direkte, për sa i përket vepres penale, Neni 284 prg.2 i Kodit Penal. Pra kjo vepër penale është kryer me faj nga të pandehurit dhe në formën e dashjes direkte.

2-Edhe sa i përket cilësimit juridik të faktit penal të kryer nga i pandehuri Qerim Tresa, Neni 280 i Kodit Penal, nën titull "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", i cili në tërësi të tij, parashikon se :

- *"Prodhimi, mbajtja, shitja ose blerja e armëve të gjuetisë ose sportive, si dhe e municioneve të tyre, pa leje të organeve kompetente shtetërore, përbëjnë kundërvajtje penale dhe **dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.***

Objekti i vepres penale: Janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar rendin dhe sigurinë publike nga veprime të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme dhe konkretisht nga mbajtja dhe përdorimi pa lejen e organeve kompetente të armëve të gjuetisë apo armëve sportive. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji penal, duhet që arma ose municionet e mbajtura, të jenë teknikisht të aftë për të realizuar qitje.

Ana objektive: Kjo vepër penale është realizuar me mbajtjen e një arme gjuetie apo sportive në kuptim të ligjit "Për armët" (i ndryshuar në vitin 2014), ku i pandehuri Qerim Tresa ka mbajtur një armë gjahu e llojit tip "çifte" me numër K06757, dhe nga verifikimi i kryer në sistem rezulton se ky shtetas është i pajisur me leje për armë gjahu por me numër AA170001.

Subjekti i vepres penale: Është subjekt i përgjithshëm i kësaj vepre penale, pasi sipas të dhenave në dosje i pandehuri Qerim Tresa është mbi 16 vjeç, i përgjegjshëm para ligjit penal, pasi nuk u konstatua asnjë shkak të parashikuar nga Nenet 12/2 dhe 17 të K.Penal që e përjashton atë nga përgjegjësia penale. Gjithashtu gjatë gjykimit nuk u ngrit dhe nuk u provua ndonjë pretendim për papërgjegjshmeri mendore të tij në kryerjen e veprës penale për të cilën ai akuzohet.

Ana subjektive: I pandehuri Qerim Tresa konsumuar edhe anën subjektive të kërkuar për këtë vepër penale pasi me dashje direkte, dhe qëllim të caktuar ka mbajtur armë gjuetie, pa marrë leje paraprake nga organet përgjegjëse duke e ditur që për përdorimin e tyre duhet të merrej një autorizim paraprak.

Pra në referim të analizës së mësipërme, nisur edhe nga nga akti i ekspertimit se bimët e mbjella në parcelën e shpyllëzuar janë evidentuar janë bimë narkotike të llojit "Cannabis sativa L. Ky fakt është pranuar dhe nga vetë të pandehurit Altin Plaku, Mondi Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa si në hetimet paraprake ashtu dhe në gjykim. Pavarësisht arsyeve që kanë shtyrë të pandehurit për të kryer këtë veprim, këto arsye nuk kanë rëndësi për kualifikimin e veprës penale, e cila është konsumuar plotësisht me veprime aktive dhe në bashkëpunim nga ana e të pandehurve. Nga të dhënat e administruara në dosjen

gjyqësore si dhe nga vëzhgimet e kryera gjate hetimit paraparak ka rezultuar se kultivimi i lëndës narkotike është kryer në bashkëpunim nga të gjithë të pandehurit.

Pra në kuptim të Nenit 25 të Kodit Penal, bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre që janë organizatorët, ekzekutorët, shtytësit dhe ndihmësit. Bashkëpunimi nënkupton pjesëmarrje aktive e dy ose më shumë personave dhe marrëveshja si element thelbësor i bashkëpunimit. Kërkohe marrëveshja por jo njohja midis bashkëpunëtorëve. Vepra penale konsiderohet se është kryer në bashkëpunim kur është vërtetuar marrëveshja e mëparshme. Marrëveshja arrihet në faza të ndryshme, para fillimit ose gjatë kryerjes së saj. Për të patur bashkëpunim nuk presupozon unitetin e qëllimit dhe të motiveve nga të cilat nisen pjesëmarrësit në kryerjen e veprës penale.

Në rastin konkret, nisur edhe nga procesverbalet e transkriptimeve të bisedave telefonike të përgjuara rezultoi se bashkëpunëtorë në kultivimin e bimëve narkotike përveç të pandehurve Mondit Vervali, Zyber Tusha, Qerim Tresa janë edhe të pandehurit Klajdi Tresa dhe Altin Plaku, pasi këta shtetas kanë komunikime relativisht të konsiderueshme për sigurimin e paisjeve të nevojshme për procesin e kultivimit të bimëve narkotike (automjete, zorrë uji, etj).

Po ashtu nga hetimet paraprahe, ka rezultuar gjithashtu se, në telefonin e shtetasit Mondit Vervali janë gjetur pamje filmike të tokës ku kultivoheshin bimët narkotike (1.114 bime) dhe të shtetasve Zyber Tusha, Altin Plaku dhe Klajdi Tresa, pra në rastin konkret bashkëpunimi është element përbërës i dispozitës, çka sjell që kjo veprë të kualifikohet në paragrafin e dytë dhe për këtë arsye keta shtetas nuk janë akuzuar edhe për Nenin 25 të Kodit Penal, ku parashikohet bashkëpunimi.

Neni 47 i Kodit Penal, parashikon se: “Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së Përgjithshme të këtij Kodi, kufijtë e dënimit që parashikohet për këtë veprë penale, rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.”

- Vepra penale që akuzohen të pandehurit Altin Plaku, Mondit Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa, Neni 284/2 i Kodit Penal, **parashikon dënim me burgim me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.**
- Kurse vepra penale që akuzohet i pandehuri Qerim Tresa, Neni 280 i Kodit Penal, **parashikon dënim me gjobë ose me burgim deri në dy vjet**”.
- Përsa i perket rrezikshmërisë së veprës penale, Neni 284/2 i Kodit Penal të kryer nga të pandehurit Altin Plaku, Mondit Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa, ajo paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore, pasi ka një përhapje të gjerë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Edhe sa i perket rrezikshmërisë së veprës penale, Neni 280 i Kodit Penal, ajo paraqet rrezikshmëri relativisht të lartë shoqërore, pasi përbën kundërvajtje penale.
- Kurse në lidhje me rrezikshmërinë e të pandehurve Altin Plaku, Mondit Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa, Gjykata konkludon se të pandehurit paraqesin rrezikshmëri të ulët shoqërore, pasi rezultojnë të pa dënuar më parë për ndonjë veprë tjetër penale, **kjo** sipas Çertifikatave Elektronike, të administruar në fashikullin hetimor të prokurorisë.

Neni 48 dhe 49 të Kodit Penal parashikon rrethanat që lehtësojnë dënimin, duke marrë në konsideratë gjykata edhe rrethanat tjera, përveç atyre të parashikuara nga Neni 48 i Kodit Penal, për sa kohë i quan që justifikojnë lehtësimin e dënimit.

Në rastin konkret gjykata mban parasysh:

- Faktin që të pandehurit kane treguar bashkëpunim me organet e drejtësisë gjatë hetimit paraprak, ashtu dhe gjatë gjykimit,
- faktin që këta të pandehur e kanë pranuar akuzën për te cilën ata akuzohen, dhe kanë treguar pendim të thelle në lidhje me kryrjen e veprës penale si ne hetim, ashtu edhe ne gjykim,
- moshën e tyre të re, Altin Plaku, i vitlindjes 1986, Mondi Vervali, i vitlindjes 1993, Zyber Tusha, i vitlindjes 1979,
- faktin që familja e të pandehurit Altin Plaku përbehet nga katër persona, është kryefamiljar dhe është i vetmi person që siguron të ardhura në familje, gjithashtu me dy fëmijë të mitur, Emili Plaku rezulton e datëlindjes 26.12.2014 dhe Esra Plaku rezulton e datëlindjes 25.01.2017, kjo sipas Çertifikës Familjare, datë 09.06.2022, po ashtu faktin që gëzon respekt në komunitetin ku ai jeton dhe banon, kjo sipas Karakteristikës datë 08.06.2022 të lëshuar nga Njësia Administrative Gjepalaj të Bashkisë Shijak,
- faktin që familja e të pandehurit Mondi Vervali përbëhet nga gjashtë persona, pra jeton me të dy prindërit dhe vajzën e tyre të mitur Kristela Vervali, e cila rezulton e datëlindjes 18.08.2020, pra rreth 2 dy vjeç, kjo sipas Çertifikës Familjare, datë 08.06.2022, po ashtu faktin që gëzon respekt në komunitetin ku ai jeton dhe banon, kjo sipas Karakteristikës datë 08.06.2022 të lëshuar nga Njësia Administrative Gjepalaj të Bashkisë Shijak,
- faktin që i pandehuri Zyber Tusha, është i divorcuar dhe jeton me të vëllain e tij në një banesë, kjo sipas Çertifikës Familjare, datë 07.06.2022,
- faktin që gëzon respekt ne komunitetin ku ai jeton dhe banon, kjo sipas Vërtetimit datë 10.06.2022 të lëshuar nga Njësia Administrative Rrashbull të Bashkisë Durrës,
- gjendjen ekonomike dhe familjare të tyre,
- moshen relativisht madhore të të pandehurit Qerim Tresa, i vitlindjes 1963,
- nivelin kulturor dhe arsimor të tyre,
- faktin që i pandehuri Qerim Tresa është hetuar nën masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi”, si dhe rrethana të tjera të vleresuara nga gjykata nëpërmjet bindjes së saj te brendshme, referuar në tëresi akteve të procedimit penal të administruar si prova në gjykim.

Gjithashtu në rastin konkret, Gjykata ka parasysh edhe **Nenin 1/c të K.Penal, i cili sanksionon**: “Kodi Penal bazohet ne parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë ne caktimin e fajesisë dhe të dënimit, të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve, si dhe humanizmit”.

-**Neni 50 parshikon rrethanat renduese**. Në rastin konkret nuk ka asnjë rrethanë renduese në kryerjen e kësaj vepre penale nga secili prej të pandehurve Altin Plaku, Mondi Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa.

Si përfundim, Gjykata çmon se të pandehurit Altin Plaku, Mondi Vervali Zyber Tusha dhe Qerim Tresa duhet të deklarohen fajtor **për veprën penale të parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal**. Po ashtu lloji dhe masa e dënimit më i përshtatshëm për ta është siç u kërkua edhe nga përfaqesuesi i organit të akuzës, duke i dënuar secilin prej tyre me nga me **pesë vjet burgim**.

Në aplikim të kërkesave të Nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, secilit prej të pandehurve Altin Plaku, Mondi Vervali dhe Zyber Tusha, i ulet 1/3 e dënimit dhe ata duhet te dënohen përfundimisht me **tre vjet e katër muaj burgim**.

Por gjithashtu, Gjykata çmon se i pandehuri Qerim Tresa duhet të deklarohet fajtor edhe për kryerjen e veprës penale “Mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë”, parashikuar nga Neni 280 i Kodit Penal, duke e dënuar atë me **një vit burgim**.

-Në zbatim të Nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve të pandehurit **Qerim Tresa**, i caktohen një dënim i vetëm me **pesë vjet e gjashtë muaj burgim**.

Ne aplikim të kërkesave të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit **Qerim Tresa**, i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht ai duhet të dënohet me **tre vjet e tetë muaj burgim**.

Por, Gjykata konkludon se të pandehurit Altin Plaku, Mondi Vervali dhe Zyber Tusha me qëndrimin e tyre në hetim dhe në gjykim, si dhe referuar rrethanave lehtësuese të lartpërmendura, paraqiten si persona ndaj të cilit duhet t’i pezullohet ekzekutimi i vendimit me burgim dhe duke patur parasysh të gjitha rrethanat e sipërpërmendura, sipas kërkesës që kërkoi edhe përfaqëuesi i prokurorisë dhe vetë të pandehurit nëpërmjet mbrojtësit ligjor të tyre.

Bazuar në Ligjin Nr.36/2017, për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995” Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, gjithashtu referuar edhe Nenit 59 të K.Penal, dispozitë e cila parashikon se: “Per shkak te rrezikshmerise se paket te personit, moshes, kushteve shendetesore apo mendore, menyres se jeteses dhe nevojave veçanerisht atyre qe lidhen me familjen, shkolimin ose punen, rrethanave te kryerjes se veprës penale, si dhe te sjelljes pas kryerjes se veprës penale, gjykata kur jep dënim me burg deri ne pese vjet, mund te urdheroje qe i denuari te mbaje kontakte me sherbimin e provës dhe te vihet ne prove, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht qe gjate kohes se provës te mos kryeje veper tjeter penale”.

Në rastin konkret në shqyrtim, të pandehurit Altin Plaku, Mondi Vervali dhe Zyber Tusha paraqesin rrezikshmeri të pakët shoqërore, pasi rezultojnë të padënuar më parë, gjithashtu secili prej tyre ka mbajtur qëndrim pohues dhe pendues në hetimet paraprake, ashtu dhe në gjykim, kanë treguar bashkëpunim me organet e drejtësisë gjatë hetimit paraprak, ashtu dhe gjatë gjykimit, janë hetuar me masë sigurimi personal “arrest në burg”, ç’ka do të thotë se e kanë vujatur një pjesë të dënimit në paraburgim, gjëndjen e vështire ekonomike dhe atë famjare, gjithashtu faktin që familjet e tyre dhe vetë ata janë persona që gëzojnë respekt në komunitet, fakte këto të relaturore sa më sipër, etj .

Pra, është rasti që gjykata të aplikojë Nenin 59/4 të Kodit Penal, pezullimin i ekzekutimit të dënimit me burgim të pavuajtur duke filluar afati i provës nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës.

Vënien në provë e secilit prej të pandehurve Altin Plaku, Mondi Vervali dhe Zyber Tusha për një periudhë kohe **prej tre vjetësh**, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejnë veprë tjeter penale.

Gjatë kohës së provës secili prej të pandehurve Altin Plaku, Mondi Vervali dhe Zyber Tusha, duhet të mbajnë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës që mbulon vendbanimin e secilit prej tyre.

Në zbatim të Nenit 60/9 të Kodit Penal, detyrimin e secilit prej të pandehurve Altin Plaku, Mondi Vervali dhe Zyber Tusha, që të mos shoqërohen me persona të dënuar.

Kurse lidhur me pretendimin e të pandehurit Qerim Tresa, të parashtruar nëpërmjet mbrojtësit ligjor të tij, avokatit Edvis Gorishti, gjykata nuk u bind ne lidhje me këtë kërkim për faktin se nuk u paraqit asnjë argument i bazuar në ligj dhe në prova, për më tepër nga aktet e administruara në tërësi në cilësinë e provës shkresore, si : Fotografi të parcelës me bimë cannabis sativa të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në datën 30.06.2021; Procesverbal i këqyrjes së vendit të ngjarjes, datë 02.11.2020; Procesverbal i këqyrjes së pamjeve filmike të telefonit të shettasit Mondit Vervali, datë 29.07.2021;

Raport-Sherbimi, datë 29.07.2021 të përpiluar nga punonjësit e policisë; Procesverbale të sekuestrimit të provave materiale, datë 29.07.2021. Procesverbale të transkriptimit të bisedave telefonike të përgjura të dërguar nga Sektori i Përgjimit të Komunikimeve Elektronike në Prokurorinë e Përgjithshme me shkresën Nr.330, datë 27.07.2021; Fletë Printim nga sistemi i regjistrimit të armëve të gjahut; Akt ekspertimi kimik Nr.8428, datë 27.08.2021. Pra nisur nga sa më sipër, në rastin konkret ka rezultuar kundërta e këtij pretendimi, pasi nga pamje filmike është shfaqur një parcelë e mbjelle me lëndë narkotike “Canabis Sattiva” nga shtetasit Altin Plaku, Mondi Vervali, Zyber Tusha dhe Qerim Tresa.

Të gjitha provat e cituara më sipër përputhen dhe me deklaratimet e e njeri-tjetrit dhe krijojnë bindjen tek gjykata që vepra penale e parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal është kryer në bashkëpunim.

Po ashtu i pa bazë mbetet edhe pretendimi i mbrojtjes për pafajësi të të pandehurit Qeim Tresa për veprën penale “Mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë”, të parashikuar nga Neni 280 i Kodit Penal, kjo për faktin se gjatë kontrollit të ushtruar këtij shtetasi, ndër të tjera i është gjetur edhe arma e gjahut tip "çifte" me numer K06757, por nga verifikimi i kryer në sistem rezultoi se ky shtetas është i pajisur me leje për armë gjahu me numër AA 170001, e cila bën që kjo vepër të kualifikohet në Nenin 280 të Kodit Penal.

Lidhur me pretendimin e të pandehurit Qerim Tresa, për aplikimin e Nenit 59 të Kodit Penale, **Gjykata çmon se i pandehuri me qëndrimin e tij si ne hetim, ashtu dhe në gjykim, nuk paraqitet si një person ndaj të cilit mund t'i pezullohet dënimi me burgim.**

Pasi referuar Nenit 59 të Kodit Penal, i cili parashikon se: “Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe nevojave veçanerisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdherojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale”.

Ne rastin konkret nën shqyrtim, i pandehuri Qerim Tresa nuk u paraqit në asnjë seancë gjyqësore, pavarësisht se gjykata e njoftoi atë rregullisht sipas dispozitave ligjore, dhe po ashtu nuk i provoi gjykatës ndonjë nevojë, rrethanë, arsye shëndetësore apo mendore që ndikon keq nëse dënohej me burgim, mënyrën e jetesës, që mund të jetë në një gjendje të dobët ekonomike familjare, pavarësisht se dënimi për të u dha më pak se pesë vjet, etj.

Pra të gjitha rrethanat lehtësuese që ekzistojnë në rastin konkret, por u morën parasysh nga gjykata në caktimin e masës së dënimit, konkretisht u dha një dënim më i ulët se ai i kërkuar nga organi i prokurorisë, pasi ai rezultoi të ketë kryer dy vepra penale.

Nisur nga sa u arsyetua më sipër, vuajtja e dënimit për të pandehurin **Qerim Tresa**, duhet të filloi nga dita e arrestimit në flagrancë, datë 29.07.2021. Kurse sa i përket **përcaktimit të llojit të sigurisë të Institucionit të ekzekutimit të dënimit penal**, pra vendit të vuajtjes së dënimit penal me burgim për të pandehurin **Qerim Tresa** në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” të ndryshuar, Gjykata çmon që vuajtja e dënimit penal me burgim të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

Kurse sa i përket provave materiale të sekuestruara gjatë hetimeve paraprake, Gjykata disponon mbi to, duke iu referuar Nenit 190/1 gërma b” dhe “ç” të K.Pr.Penale, dhe konkretisht lënda narkotike e llojit “Cannabis Sativa” e sekuestruar sipas “Procesverbalit për sekuestrimin e sendeve”, datë 29.07.2021 duhet të asgjësohet. Kurse një armë gjahu (çifte me ngjyrë të zezë me fund druri ngjyrë kafe me numër serial K06757, në fund të saj me shënimin “Model 12 Sport 12”, duhet të kalojë në favor të shtetit.

Gjykata në referim të Nenit 393/1-2 të K.Pr.Penale, i cili përcakton mënyrën e disponimit të gjykatës mbi “shpenzimet procedurale”, duke nënkuptuar tërësinë e shpenzimeve të parapaguara nga shteti gjatë gjithë

proçedimit penal, qe nga hetimet paraprake deri në dhënien e vendimit nga gjykata, bazuar dhe në Nenin 485/3 të K.Pr.Penale, u ngarkohen solidasht të gjitha shpenzimet proçedurale të pandehurve.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në Nenin 284/2, 280 dhe 59/4 të Kodit Penal, si dhe Nenet 379, 384, 390, 406/1 dhe 485 të Kodit të Proçedurës Penale,

V E N D O S I:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Altin Plaku**, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me **pesë vjet burgim**.
 - Në aplikim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit **Altin Plaku** i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet **tre vjet e katër muaj burgim**.
 - Në zbatim të Nenit 59 prg.4 të Kodit Penal, pezullimin i ekzekutimit të dënimit me burgim **për pjesën e vuajtur** duke filluar afati i provës nga e nesërmbja e shpalljes së vendimit të gjykatës.
 - Vënia në provë e të pandehurit **Altin Plaku** për një periudhë kohe prej **tre vjetësh**, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.
 - Gjatë kohës së provës i pandehuri **Altin Plaku** të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë.
 - Në zbatim të Nenit 60/9 të Kodit Penal, detyrimin e të pandehurit **Altin Plaku**, që të mos shoqërohet me persona të dënuar.
 - Në aplikim të Neneve 261/1-b dhe 262 të K.Pr.Penale, Gjykata deklaroi shuarjen e masës së sigurimit “Arrest në burg” dhënë ndaj të pandehurit **Altin Plaku**, me vendimin Nr.2171/1Regj.Themeltar, datë 03.01.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
 - Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i tij, nga I.E.V.Penale “Jordan Misja “ Nr. 313, në qoftë se nuk mbahet për ndonjë masë sigurimi, dënim ose çështje tjetër penale.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Mondi Vervali**, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me **pesë vjet burgim**.
 - Në aplikim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit **Mondi Vervali** i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet **tre vjet e katër muaj burgim**.
 - Në zbatim të Nenit 59 prg.4 të Kodit Penal, pezullimin i ekzekutimit të dënimit me burgim **për pjesën e vuajtur** duke filluar afati i provës nga e nesërmbja e shpalljes së vendimit të gjykatës.
 - Vënia në provë e të pandehurit **Mondi Vervali** për një periudhë kohe prej **tre vjetësh**, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.
 - Gjatë kohës së provës i pandehuri **Mondi Vervali** të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë.
 - Në zbatim të Nenit 60/9 të K.Penal, detyrimin e të pandehurit **Mondi Vervali**, që të mos shoqërohet me persona të dënuar.
 - Në aplikim të Neneve 261/1-b dhe 262 të K.Pr.Penale, Gjykata deklaroi shuarjen e masës së sigurimit “Arrest në burg”, të caktuar ndaj të pandehurit **Mondi Vervali**, me vendimin Nr.1301 Regj.Themeltar, datë 01.08.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i tij, nga I.E.V.Penale “Jordan Misja” Nr. 313, në qoftë se nuk mbahet për ndonjë masë sigurimi, dënim ose çështje tjetër penale.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Zyber Tusha**, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me **pesë vjet burgim**.

- Në aplikim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit **Zyber Tusha**, i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet **tre vjet e katër muaj burgim**.
- Në zbatim të Nenit 59 prg.4 të Kodit Penal, pezullimin i ekzekutimit të dënimit me burgim **për pjesën e vuajtur** duke filluar afati i provës nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit të gjykatës.
- Vënia në provë e të pandehurit **Zyber Tusha**, për një periudhë kohe prej **tre vjetësh**, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.
- Gjatë kohës së provës i pandehuri **Zyber Tusha**, të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë.
- Në zbatim të Nenit 60/9 të Kodit Penal, detyrimin e të pandehurit **Zyber Tusha**, që të mos shoqërohet me persona të dënuar.
- Në aplikim të Neneve 261/1-b dhe 262 të K.Pr.Penale, Gjykata deklaroi shuarjen e masës së sigurimit “Arrest në burg” dhënë ndaj të pandehurit **Zyber Tusha**, me vendimin Nr.1301 Regj.Themeltar, datë 01.08.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i tij, nga I.E.V.Penale “Jordan Misja” Nr.313, në qoftë se nuk mbahet për ndonjë masë sigurimi, dënim ose çështje tjetër penale.

4. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Qerim Tresa**, për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/2 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me **pesë vjet burgim**.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Qerim Tresa**, për kryerjen e veprës penale “Mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë” të parashikuar nga Neni 280 i Kodit Penal, dënimin e tij me **një vit burgim**.
- Në zbatim të Nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve të pandehurit **Qerim Tresa**, i caktohen një dënim i vetëm me **pesë vjet e gjashtë muaj burgim**.
- Në aplikim të Nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit **Qerim Tresa**, i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht dënohet me **tre vjet e tetë muaj burgim**.
- Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Qerim Tresa**, të fillojë nga dita e arrestimit në flagrancë, datë 29.07.2021 dhe të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.
- Në referim të Nenit 190/1 gërma “ç” të K.Pr.Penale, prova materiale lënda narkotike “Cannabis Sativa” e sekuestruar sipas “Procesverbalit për sekuestrimin e sendeve”, datë 29.07.2021 të asgjësohet. Kurse një armë gjahu (çifte me ngjyrë të zezë me fund druri ngjyrë kafe tme numër serial K06757, në fund të saj me shënimin “Model 12 Sport 12” të kalojë në favor të shtetit.
- Shpenzimet proceduriale hetimore dhe gjyqësore i ngarkohen solidarisht të pandehurve.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
- **U shpall në Tiranë, sot më datë 26.07.2022.**

SEKRETAR
ROMEO SHEHU

GJYQTAR
KUJTIM VRANIÇI

SHPENZIMET GJYQËSORE

Prokuroria	Në total	3 000 Lek
Masë sigurimi	Në total	Nuk ka
Seanca Paraprake + Themel	Njoftimet 6 x 150 = Av. kryesisht	900 Lek. 3 000
Shpenzimet	Në total	6 900 Lek.